



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

Nga procesverbali i mbledhjes së 28-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 29.03.2024, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Gentianë Hoxhaj, anëtare
14. Venhar Agushi, anëtar
15. Xhyla Dedushaj, anëtare
16. Lulzim Rustemi, anëtar
17. Herolind Kozhani, anëtar
18. Ardit Cani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Egzona Bytyqi, anëtare
21. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
22. Ganimete Qeriqi, anëtare
23. Alban Salihu, anëtar
24. Fitim Meziu, anëtar
25. Fadil Spahiu, anëtar
26. Fatmir Fetahu, anëtar
27. Shahadije Dragaçina, anëtare
28. Besiana Syla, anëtare
29. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës
3. Lulzim Rrustemi, nënkryetar i komunës
4. Latif Ramadani DBF
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Shkelzen Hajdini, DSH
7. Elmaze Behluli, DA
8. Sead Aliu, DI
9. Rexhep Rexhepi, DBP
10. Rasim Hasani, DA
11. Safete Amerrlahu, DGJK
12. Burim Rrustemi, DSHPMSH
13. Imri Semetishti, DUPMM
14. Anila Reqica-LLugiqi, DKRS
15. Flamur Sylejmani, DI
16. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se ju uroj një vit të mbarë dhe suksese. Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 27-të e Kuvendit.
2. Propozim Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Mehdi Zejnullahu” në Lipjan.
3. Propozim Vendim për miratimin e Planit lokal të veprimit për barazinë gjinore 2024-2026.
4. Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, ZK Grackë e Vjetër.
5. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Grackë e Vjetër.
6. Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës, ZK Lipjan.
7. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan.
8. Propozim Vendim për formimin e Komisionit të Ankesave.
9. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.
10. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer për subvencionimin e qumështit.

Pastaj Kryesuesi e hodhi ne votim rendin e ditë së propozuar dhe pas votimit u konstatua se me 25 vota per u aprovua rendi ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Arsim Jashari, tha se pari ne emër te grupit te PDK-së, ua uroj muajin e shenjtë të ramazanit. Pastaj tha se vitet e 90-ta kanë qenë shumë të vështira për popullin shqiptare, futbollistet e kësaj kohe dhanë gjithçka madje edhe rrezikuan jetën e tyre për ta mbrojtur dhe te mbajtur gjallë sportin dhe futbollin në Kosovë. Andaj kërkoj nga drejtoria për Kulture Rini dhe Sport qe te ju shpërndaj mirënjohje këtyre për kontributin e dhënë gjatë viteve 90-99. Është një shqetësim qytetarëve për kabllo e rrjetit neper fshatra, është mirë qe te bëhen një rregullore për këtë çështje, pasi qe janë bërë shume kabllo nëpër shtyllat elektrike. Kërkesa e dytë është shkolla e vogël në fshatin Banullë, nëse nuk keni buxhet me renovuar të paktën me ndonjë foli me i mbështjell dritaret ne mënyrë te improvizomë te paket mos te dëmtohet dhe me shumë. Ajo është ndër shkollat e para në komunën e Lipjanit. Kërkesë tjetër nga shoqata e gjahtarëve Sokoli, kërkojnë mbështet financiare. Pyetje për DKA-ë, a është e vërtetë qe në kohën e iftarit po mbyllen shkollat nëse është e vërtetë, është shqetësuese. Kërkesë nga banorët e rrugës Drenicakët në Bnaullë për zhavorrimin e rrugës së tyre.

Lulzim Rrustemi, tha se unë e kam një propozim qe ne mbledhjen e ardhshme te kemi një pike ne kuevnd,gjendja e arsimit ne komunën e Lipjanit, pasi qe ne raportin e fundit pat shume gabime. E dyta janë përmirësuar gabimet ne raport pasi qe kane qene gabime shume te mëdha. Propozimi tjetër e kam qe te kthehet ne Kuvend rregullorja për bursa dhe te kthehet neni për studentet qe studiojnë jashtë shtetit. Tjetra sipas banoreve te Rufcit dhe fshatareve për rreth çerdhja ne Rufc ka përfundua, qytetarët pyesin se kur pritet me fillua me punuar çerdhja. Kërkesë për DKRS-së, qe te funksionalizimet qendra kulturore. Të shëndetësia a ka ndonjë plan për funksionalizimin e AFM-ve në Banullë dhe Smallushë . Pyetje për DKRS-në kur pritet te fillohet ndërtimi i qendrës se kulturës në Lipjan?

Shahadije Dragaçina tha se çështja e parë qe do ta ngris ka të bëjë me qendrat rinore të cilat kanë operuar te shtëpia e kulturës, sa OJQ kane operuar aty, pasi qe ato tani duhet ta lirojnë atë vend dhe a do te ju bëhet ndonjë zgjidhje atyre. Tjetra ka të bëjë me KF të vajzave në Lipjan te cilat kane treguar rezultat te mira, mirëpo mjetet qe ju ka nda komuna nuk kane qen te mjaftueshme. Një shqetësim te banorëve te komunitetit ne Janjevë të cilat për shkak te vërshimeve ju ka hyrë kanalizimi në shtëpi.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se çështja e parë qe do ta gris është mirë qe te bëhet dezinfektimi i hapësirave publike te shtegu i biçikletave dhe kjo te bëhet kohë pas kohe. E dyta te ketë tabela informuese deri te shpella e Gadimes, pasi qe nuk ka tabela informuese për gjate rrugës deri te shpella. Tjetra pyetje për DKA-në, para disa viteve është ndërtuar aneksi te shkolla “Vëllezërit Frashër”, por disa klasë po dërgohen te shkolla “Adem Gllavica”. Cili është plani i DKA-së, sa i përket këtij aneksi?

Ganimete Qeriqi, tha se e kam një shqetësim te banorëve ku banojmë e qe jemi te rrezikuar nga të reshura atmosferike, pasi qe kanali qe e drenon ujin është në nivel më të ulët se te reshurat e qytetit. Dhe shpesh vullnetarisht pastrohen ato nga banorët, pasi qe niveli i kanalit është me i ulët se i qytetit.

Egzona Bytyqi, tha se i kam disa çështje për ti ngritur, e para ka të bëjë me drejtorinë e shëndetësisë ku kërkoj bashkëpunim, pasi qe muaji prill karakterizohet me aktivitete të ndryshme sa i përket atyre qe janë me autizëm dhe kërkoj nga ana e drejtorit me qen ure lidhëse, pasi qe unë kam biseduar me një psikolog klinik qe me ardhë në QKMF për te bërë një test sa i përket autizimit. Çështja tjetër kam marr disa ankesa për rrugën “ Fehmi Agani” ose rruga ka xhamia e Lipjanit pasi qe është ne gjendje shumë te keqe pas punimeve nga ujësjellësi. Tjetra si qëndron puna për rrënimin e objekteve te paraluftës ne Magure. Inspektorët e tregut qe kane kaluar me nivel qendror a keni menduar me ndaluar këtë veprim.

Ardit Cani, tha se kam për ti ngritur disa kërkesa të banorëve të fshatrave Baincë dhe Resinocv ku kanë telashe me kanalizimet qe janë bllokuar. Kërkesa tjetër është për hapjen e lumit Drenica, kërkesa e ngritur qe disa vite. Tjetra kur pritet te fillojë zhavorrimi i rrugëve bujqësore, pasi qe është një rrugë urgjente ne fshatin Baincë dhe shumë e nevojshme. Kërkesa tjetër për rrënimin e shkollës së vjetër ne fshatin Risinocv .

Herolind Kozhani, tha se kam për ti ngritur disa çështje për ti ngritur e para ka të bëjë me mirëmbajtjen e varrezave te dëshmorëve dhe martirëve nëpër fshatra kur ditët qe janë dëmtuar ndoshta nga natyra. A është planifikuar qe te ketë mirëmbajtje sivjet. Tjetra është për fushën e hapur sportive në Ribar të Madh kur pritet te investohet pasi qe edhe një muaj do te filloj turniri. Pyetje për DHSP, banorët e Ribarit të Madh kanë ankesa për mbyllje të kanalizimit, po ashtu edhe banorët e Bujanit rruga Drenica, kane te njëjtin shqetësim. Dhe e fundit para disa ditë është sulmuar një drejtor i shkollës dhe nuk ka pas asnjë reagim nga komuna e Lipjanit.

Alban Salihu, tha se në nëntor te vitit te kaluar kemi qenë dëshmitar te hapjes se sallës sportive në Lipjan, tani jemi dëshmitar dhe kemi faktuar disa foto nga dëmtimi i dyshemesë në atë sallë. Pyetja ime a po zhvillojnë aktivitete klubet sportive në atë sallë. Kur dihet qe dëmtimi për një periudhë kaq te shkurte tregon për cilësinë e dobët të punimeve. Çështja e dytë ka të bëjë me sektorin për media në komunën e Lipjanit e cila është ngritur edhe me herët si shqestim, ku nëse e shikon fotot nga mbledhja e kuvendit te epet përshtypja qe aty janë takuar bordi i drejtorëve e jo kuvendi i komunës. Dhe e fundit kohen e fundit kryetari i komunës është shume pasiv ne komunën e Lipjanit duke u marr me nivelin qendror, për përgatitje për zgjedhje qendrore, dhe ky duhet te ju kthehet qetarëve për çka i ka marr votat dhe paguhet.

Besiana Sylja, tha se i kam dy kërkesa, e para ka të bëjë me banorët e fshatit Qellapek të cilët kanë probleme me shtratin e lumit e sidomos gjatë reshjeve të shpeshta të shiut. A ka ndonjë projekt për rregullimin e shtratit të lumit. Dhe e dyta kam një shqetësim për largimin e kapakëve të kanalizimit në rrugën kryesore të fshatit Topliqan , eshët mire qe te dërgohen kapakët e rijnë.

Gentianë Hoxhaj, tha pyetja ime ka të bëjë rreth punimeve të stadiumit në fshatin Dobrajë e Madhe a kanë filluar punimet?

Rinor Murati, tha se çështja e parë qe do ta ngris është rreth bursave, a do të përkrahen edhe këtë vit edhe nxënësit e shkollave të mesme të larta. Dhe e dyta kur do të filloj zhavorrimi i rrugëve fushore?

Fadil Spahi, tha se i kam disa kërkesa dhe pyetje, kërkesa e parë ka të bëjë me hapjen e disa gypave te ujit në rrugën “12 qershori” në fshatin Smallushë të cilët janë mbyllur dhe gajtë vërshimeve po shkaktojnë probleme për banorët . Kërkesa e dytë ka të bëjë me komisionin për emërimin e rrugëve dhe rrugicave nga familjet Qadraku nga fshati Vërrshevc qe lidhet me rrugën 25 korriku qe rruga e tyre te emërtohet me një emër kontribut dhënës e jo me një emër të asaj lagje. Pyetje për drejtorinë e infrastrukturës për asfaltimin e rrugës së varrezave qe gjinden afër shkollës në fshatin Smallushë. Pyetja tjetër nga familjet sopa për asfaltimin e rrugicës së tyre te cilët e kane dhen pëlqimin qe rrugica e tyre te asfaltohet.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se do te mundohet te ju përgjigjem disa prej pyetjeve, është mirë nganjëherë me qenë mirënjohës edhe për rrugët qe janë shtruar ne Smallushe janë shtruar 90%. Mund te ketë mbyllje te urave apo te gypave, por mire qe kemi ardh ne këtë situatë. Sa i përket emërimit te rrugëve do ta keni në seancat e ardhshme ne kuvend, një temë qe vet komisionit ju ka shkaktuar telashe. Sa

i përket rrugëve fushore, ne kemi hy me një agjende, dhe do te zhavorrohen rrugët qe lidhen me rrugën kryesore. Është një projekt dy vjeçar. Bursa do te ketë edhe ketë vit dhe vitin e ardhshëm. Bursistet jashtë vendit marrin edhe jashtë burse po mund ta fusim prape. Stadiumet në Dobraje dhe Magure janë ne tender dhe shumë shpejt do te funksionalizohen. Kapakët e pusetave një problematike qe po na ndodh shpesh. Ne Qellap, do ta marrim parasysh si komune, urën. Ne sallë nuk ka pas kapacitet te mjaftueshëm te rrymës dhe aty KEDC do ta bije një trafo ekstra dhe shume shpejte do te funksionalizohet. Mirëmbajtja e varrezave jemi ne proceduar pasi qe na ka skaduar kontrata por do te vazhdojmë prape. Kanalizimi ne Ribar te Madh, kemi intervenuar po do te intervenojmë prape. Në ulëse është intervenuar edhe do te intervenohet edhe ne bari. Rrënimi i shkollës jo vetëm në Risinovc po edhe ne disa fshatra tjera do te rrënohen disa objekte te vjetra. Po ashtu edhe hapja e lumit Drenica do te bëhet. Te inspektoret e tregut sanitar kadastrat dhe rojeve te pyllit i ka marr nivelit qendror dhe ka shkaktuar telashe. Po bëjnë centralizim te shërbimeve. Në Magure kemi marr pëlqimin prej AME-së, për rrënimin atyre objekteve. Rruga "Fehmi Agani" e drejtë është dëmtuar shumë, dhe ujësjellësi nuk e ka kryer ne gjendjen e me parshme ne kemi bërë shkresë përmes gjykatës, dhe ne kemi probleme me këto kompanitë si ujësjellësi Pastrimi dhe KECD etj. Dezinfektimin te shtegu, mund ta bëjmë. Ndërsa rruga për te shpella është përgjegjësi e nivelit qendror. Sa i përket OJQ-ve, dhe klubeve sportive nuk kemi mundësi me i mbështet 100% dhe këtu e kemi situatën ku i njëjti njeri ua ka mbush nijet te gjithëve dha ka dështua si shpallje. Te zyrat për OJQ, ne në Lipjan i kemi 32, por ne nuk mujme te gjithave zyre me ju siguruar dhe OJQ-të, kur aplikojnë për projekte e shënojnë se kanë zyre. Ne e kemi obligim me ligj vetëm KQZ-së, mi sigurua zyre. Qendra e kulturës është në projekt, pasi qe kemi pas ankimin ne OSHP. Çerdhja ne Rufc jemi ne procedure për ta hap atë çerdhe, por kemi numër të vogël te personelit arsimor pasi qe nuk po na lejohet me marr. I ftoj qe ti regjistrojnë fëmijët ne çerdhe ajo pjesë. Shkolla në Banullë do të mundohemi qe ta fusim ne agjende. Shoqata Sokoli, dhe një shoqatë tjetër, ndoshta e drejtë nuk e di. Nuk mund ta mohojmë faktin qe shkollat po mbyllen për shkak te kohës se iftarit ne te gjithë Kosovën. Sportistet e vjetër jam për me i mbështet. Sa i përket reagimit për drejtorin e shkollës nuk kemi reaguar pasi qe sa me shume reagohet po rritet.

Ganimete Qeriqi, tha se për shestimin e banorëve et lagjes ku banoj unë nuk u përgjigje.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha nuk e di për rastin por do ti dërgoj drejtorinë përkatëse ne teren dhe do ta shohim.

Arsim Jashari, tha se e kam një pyetje, e ke pas cek qe do ti rritesh shumen për mirëmbajtjen e investimeve , pasi qe është shqetësuese çfarë investimet po bëhen edhe shkaku i një dëmtimi ai po demolohet, dhe kjo po bëhet nga persona te pa përgjegjshëm.

Alban Salihu, tha se ne seancat e kaluara kemi dëgjuar kryetarin e komunës duke e cituar Ismail Kadarenë dhe këtu i përshtatet thënia për sallën e sportit ra ky mot e u pamë, u dasht me pa dëmtimin e dyshemesë se sallës qe me kuptua qe investimi është i përbashkët me qeverinë e Kosovës. Kjo e godet argumentin e kryetarit qe po sabotohen dhe nuk po investohet nga Qeveria e Kosovës, unë gjate një takimi me zyrtar te Ministrisë me kane thëne qe mbikëqyrësi ka qen një nga ministria një nga komuna.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se po do te rritet mjetet për mirëmbajtje te investimeve por pak bile po duket me raport me investimet qe janë bere ne teren. Investimi i palestrës sportive është kontraktuar para kohës së pandemisë dhe me mujt kjo qeveri i kish ndal.

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 27-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 27 e Kuvendit , pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 25 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 27-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Propozim Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Mehdi Zejnullahu” në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit, drejtor i DSHPS-së ,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Nexhmedin Lekiqi, tha se ne Kuvend na ka ardh Statuti i QKMF-së, por ne komiteti i shëndetësisë nuk kemi qenë te involvuar me herët por sot e morëm njoftimin dhe sikur ta kishim edhe ne do kishim dhënë një kontribut. Duhet te kemi kujdes se çka do te bëjmë me këtë statut pasi qe nesër qytetaret do te thirren ne ketë statut. Ne statut duhet te përfshihet edhe shëndeti mendor dhe me i ofruar njerëzit specialist për shëndetin mendor, nuk mujn mjekët familjar e te përgjithshëm te merren me shëndetin mendor. Diçka tjetër qe është ne statut e na nuk jemi te përgatitur është kujdesi për ateizëm dhe për fëmijët me ngecje psike motorike qe është drejtim i veçantë dhe Lipjani nuk ka profil te tillë dhe është vështirë me i siguruar. Po ashtu në statut është bere përpjektë qe mjekët familjarë te aftësohen me ultrazë. Është dashtë qe disa gjere te diskutohen me herët, por unë e përkrahi këtë statut.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se statuti ka qenë në debat publik, nuk e di a e keni pas me herët në email ,obligim secili komitet e ka me diskutua si çështje. Nuk e ka obligim drejtori me thirr komitetin me diskutua.

Gazmend Qerkini, tha se nga anëtarët e komisionit është bërë një punë e mirë, dhe si komision i kemi trashëguar disa asete dhe jemi munduar me i ruajttë. Ne grupi i LDK-së, e mbështesim këtë propozim.

Fitim Mëziu, tha se do te filloj diskutimin për statutin ne disa çështje, për qytetarët tone te cilën marrin shërbime ne institucionet tona. Pra si qellim i joni është qe para vetes ta kemi prekjet statutin e QKMF-së qe është dokumenti bazë, i organizimit te kujdesit primar shëndetësor, duke përfshirë QKMF-në, QMF-të dhe AMF-të. Për statutin është themeluar një komision i cili ka bërë më shumë një përshkrim te udhëzimit. Shtetësia a është e centralizuar apo e ministrisë shtohet pyetja? Statuti fillon me ndryshime kërkesa, ne nenin 1 statuti e ka planifikimin dhe punësimin e punëtoreve, ndërsa drejtoratit i mbetet vetëm me zgjedh ndonjë drejtor apo zëvendës drejtor. Ndërsa te paragrafi 2 themelues i QKMF-së, është Kuvendi Komunal nuk ka datë kur është themeluar QKMF-ja. Nuk është e detajuar kur ka filluar punën QKMF, deh në vitin 1959 nuk ka pas QKMF kane qene shtëpi te shëndetit. Shtohet pyetja cili është roli i mjekut ne mjekësinë familjare? Po ashtu te përmendet dipanzeri për QKMF, po na nuk kemi pumulog qe do te ishte shumë i rëndësishëm. Te statuti ne QKMF tash kemi edhe zyrën e prokurimit, apo ashtu edhe

lista e QKMF dhe AMF, mirëpo AMF ne Bnauille dhe Smallsuhe nuk funksionojnë. Unë nuk do ta votoj këtë statut dhe kërkoj nga anëtarët kuvendit te shtyhet dhe te formohet një komision tjetër dhe ta bëjmë një statut si duhet.

Besiana Syla, tha se unë e kam lexuar statutin e QKMF-së dhe i kam disa pyetje, cili është qëllimi i ndryshimit të statutit pasi që nuk ka ndryshim plotësim të tij. Ky ndryshim ka te beje me ndryshime ligjore apo ka reforma brenda QKMF-së, nëse ka reforma cilat janë ato?

Egzona Bytyqi, tha se sa i përket statutit unë e kam lexuar me një interes te veçantë, është bere një përfshirje ete gjitha kompetencave përgjegjësive fushëveprimit që e ka QKMF-ja. Ajo që dëshiroj që këto shërbime te avancohet dhe te jenë sa me cilësore. Te Autizmi dhe te ngecjet psike motorike do te ishte mire me u përdor një terminologji me e bute mjekësore. E dyta problem Mamaografi e cila është domosdoshmëri e kohës. Me kritikate që dhe dr Meziu pajtohen me disa prej tyre.

Lulzim Rrustemi, tha se kemi te bëjmë me një akt te rëndësishëm, e për te cilin ne kemi disa vërejtje serioze për te cilin ne kërkojmë me u shtyre që me u përmirësuar dhe me u plotësuar pastaj e mardh deri te votimi. E kam një vërejtje shume themelorë që Komiteti për shëndetësi me u taku me diskutua me i dhëne rekomandime e tyre. E dyta është përshkrim detal i udhëzimit administrativ. Tjetra anëtarët e këshillit drejtues te përjetshëm që jo është e pa pranueshme. Drejtori i QKMF-së a ka mandat, apo me mandat, po ashtu edhe të zëvendës drejtori njëjtë. Ne si grup mendojmë që ky statut duhet me u shty mu përmirësuar pastaj me ardh ne Kuvend.

Shklezen Hajdini, tha se për statut ka punuar një komision duke u harmanizuar me udhëzimin dhe ligjet për shëndetësi, dhe ne kemi aftin që deri me 31 mars me e votuar ne kuvend. Ne jemi munduar që te bëjmë ne mënyre me te mire edhe pse kanë mujt me na ik gabime. Sa i përket shëndetit mendor mund edhe ta heqim nga statuti, mirëpo ky shërbim është i nevojshëm, dhe na kemi mundësi me provua me angazhuar dikë. Ultrazërin janë ka e bëjnë te gjitha QKMF-të, e kemi shti edhe na. Dispanserinë e mushkërive na e kemi në QKMF. Po ashtu na kemi edhe rreth 4 mijë vizita ne shtëpi te nënave me fëmijë dhe nënave lehona. Nuk e di që ka diçka te keqe nëse ka zyre te prokurimit ne QKMF. Kemi pak reforma ne QKMF. Mandatet e drejtorave dhe zyrtarëve janë te rregulluar me ligj.

Fitim Mëziua, tha se ne nuk u kuptuam si duket ne disa elemente, e para unë nuk e thash që duhet me hek dispanserinë përkundrazi e thash që është një element shume i rëndësishëm për shkak te numrit te madh te sëmurave nga tuberkulozi dhe

tash pse mos ta kemi te punësuar edhe një pulmolog. Te këshilli i pacienteve nuk e tash që është gabim, por tash mos te jetë pjese e bordit udhëheqës. Te mamografia nuk besoj që është dikush kundër, po e them që mungon.

Shkelzen Hajdini, tha se ju falënderoj për bashkëpunimin te gjithëve, na e kemi lënë që me funksionuar dispanseri. Ultrazërin e kemi pasi që edhe trajnime na janë ofruar nga oda mjekëve.

Fitim Mëziu, tha se si duket prape nuk u kuptuam, unë thash ne kemi mundësi me avancuar mjekësinë, për shembull me pranuar një mjek pulmolog.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha ju kisha lut që kur te dalin dokumentet me rendësi ne debat publik anëtarët e kuvendit te epin kontributin e tyre edhe gjate dëgjimeve publike dhe mujm ne ta ardhmen me ndryshuar.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës së Lipjanit, tha se e para për te ruajtur atë që e kemi është e gabuar, e dyta për te fut me shume çështje që nuk janë ne kuadër te legjislacionit ne fuqi prape gabim. Unë mendoj që na ma guximshëm është dasht me hy ne këtë reformë. Dhe vendet e punës nuk mund et shpallen sipas statutit po sipas ligjeve. Unë kërkoj nga njerëzit e fushës që te mbështesni me kushtin që brenda këtij viti ta plotësojmë ndryshojmë dhe ti shohim defektet që i kemi dhe unë personalisht do ti thërras. Qëllimi është me votuar për te mirën e qytetarëve e jo te ketë votim te një anshëm.

Daut Azemi, tha na po e qesim ne votim nëse ka ndonjë propozim për te ardhëm e ndryshojmë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit që te përmirësohen dhe korrigjohen gabimet teknike dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 15 vota për, 4 kundër dhe 9 abstenime, aprovoi statutin.

Pastaj u dha pauzë nga ora 12:10 deri ne 13:45.

Vazhdojmë me pjesën e dytë të kuvendit, po kalojmë ne piken e 4-te te Kuvendit pasi që nënkryetari është me një takim nëse pajtoheni pastaj ketë pike e diskutojmë kur te kthyet nënkryetari.

IV

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, ZK Grackë e Vjetër.

.Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha Imri Semetishtit, drejtor i DUPMM i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne si grup i PDK-së e mbështesim fuqishëm këtë propozim dhe shpresojmë që do të implemtohen edhe në praktikë.

Fadil Spahiu, tha se me qëllimi i këtij propozim vendimi është dhënia në shfrytëzim për ndërtimin e njërive banesore për kategoritë e dal nga lufta e UÇK-së nga komuna e Lipjanit , unë e mbështes këtë propozim vendim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi propozimin

V

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Grackë e Vjetër.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit, drejtor i DUPMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Gentianë Hoxhaj, tha ne emër të grupit të LDK-së, e propozojmë Armend Grajqevcin për anëtar të komisionit

Arsim Jashari, tha se ne grupi i PDK-së, për anëtar të komisionit e propozojmë Lulzim Rrustemin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit me ndryshimet e cekura me lartë që aty ku është komision Latif Ramadani, nderohet me Safete Amerllahu, ndërsa aty ku është Safetja vjen Latifi dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për dhe 4 abstenime, aprovoi propozimin

VI

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës, ZK Lipjan.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit, drejtor i DUPMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se dje edhe ne KPF e kemi diskutuar dhe debatuar këtë pikë dhe do të ishte mire që i njëjti debat me u zhvilluar edhe këtu. E ceka edhe dje a ka mundësi me u shty afatet për shkak se kemi disa pronar , pasi që e kemi rastin me pronën që e kemi përball saj dhe po zvarritet që disa vite për arsye se nuk po arrihet me u gjet një zgjidhje. Na dje e kuptuam që projekti ka pësuar ndryshime nga qasja prej parkut ne shesh. Na kemi bere kërkesë si grup me pa projektin dhe nuk kemi pas qasje. Me sa po shihet një nisme e komplikuar dhe nuk e di a do të ja dalim ne fund.

Imri Semetishti, tha se dje ne KPF, qasja nuk ka ndryshuar prej sheshit po nga parkingjet nëntokësorë është devijuar vetëm lindja, ndërsa tjetër ka mbet e njëjta dhe nuk do të ndryshohet. Jemi te vetishëm që procesi eshët i rend po ne pe rate kemi caktuar edhe aftin kohor. Do të përfitojnë kategoritë e dala nga lufta. Ndërsa sa i përket projektit mund ta shihni por r kemi te pa mundur që me e publikuar ose fotokopjuar për shkak te materialit voluminoz.

Fadil Spahiu, tha se me që qëllimi i shfrytëzimit te këtyre pronave është ndërtimi i banesave për kategoritë e dal nga lufta dhe me ndërtimin e këtyre banesave do te behet rrënimi i banesave që nuk i plotësojnë kushtet e banimit dhe kjo po bëhen ne te mirën e përgjithshme unë e mbështes këtë propozim vendim.

Lulzim Rrustemi, tha se unë e kam disa pyetje, cila kompani e ka bere fizibilitetin dhe a është bazuar ne hartat zonale dhe e dyta nuk e di a do te rrënohet te gjitha objektet.

Arsim Jashari, tha unë spo muj me kuptua qytetaret, po ju vjen mundësi me marr një banese me te re dhe me metra me shume dhe prape nuk po pajtohen ose po lypin për 50 metra 300 metra dhe kjo nuk ka kuptim.

Imri Semetishti, tha se studimin e fizibilitetit e ka kryer një kompania që jemi shume te kënaqur si komune dhe kemi marr disa sugjerime nga ana atyre, që përbehet prej 15 avokatëve.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se po shihet që është kuptuar rëndësia e këtij projekti, është një pune që 2 vite që o ka përcjellët nga dretori. Është një projekt i rëndësishëm dhe për mendimin tim studimi i fizibilitetit që ju ka bere këtij projekti

është nder me te mirat me te saktat. Ne ju kemi dhënë mundësinë banorëve qe banesat e tyre me i bo te reja, por ata qytetarë nuk o qe po merren vesh, dhe aty toka është e komunës.

Egzona Bytyqi, tha se e falënderoj drejtorin për elaboratin dhe sqarimit dhe ne aspektin shëndetësor e shoh shume te nevojshëm qe te ndryshohen ato dhe ne emër te grupit e mbetshim këtë propozim.

Fadil Spahiu, tha se unë pajtona me këtë fatin kohor sepse afati kohor e obligon qe me gjet një zgjidhje mirëpo nganjëherë afati kohor mundet eshë me dyfishuar çmimin

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi propozimin

VII

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit, drejtor i DUPMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albion, tha se ne emër te grupit të LDK-së e propozojmë, Rinor Muratin

Egzona Bytyqi, tha se ne emër te grupit te PDK-së, e propozojmë Lulzim Rrustemin

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për,3 abstenime, aprovoi propozimin

VIII

Propozim Vendim për formimin e Komisionit të Ankesave.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Diamnt Bytyqit, nënkryetar i komunës i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Xhyla Dedushaj, tha se si grup i LDK-së, e propozojmë për anëtar te komisionit Rinor Muratin

Ardit Cani, tha se emër te grupit te PDK-së, për anëtar te komisionit e propozojmë Herolind Kozhanin

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për, 3 abstenime, aprovoi propozimin

III

Propozim Vendim për miratimin e Planit lokal të veprimit për barazinë gjinore 2024-2026.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit drejtor i DSHPS në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se një plan i rendësi te veçantë dhe i falënderoj te gjitha grupet punuese, edhe ne si grup kemi dhënë kontributin tone dhe e mbështesim këtë propozim.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se para vetes kemi planin lokal për barazi gjinorë dhe nëse e lexon eshët përshkruar detalisht çdo element duke fuqizuar pozicionin e gruas ne shoqëri. Ku sipas këtij plani komuna e ka vizionin për qeverisje ku burrat dhe gratë janë te barabarta , po ashtu komuna promovon fuqizim dhe punësim te grave dhe te tjera. Ama te demoralizohet shpresa qe një plan do te realizohet ndonjë here kur ne komision është një burrë. Ku ne pozitat udhëheqëse kemi pak gra. Unë uroj qe ky plan do te realizohet ne praktikë.

Albion Tasholli, nga si grup i LDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim pasi qe është një hap i mire për përmirësimin te drejtave te grave ne te gjitha sferat e jetës

Shahadije Bikliqi, tha se nuk po e kuptoj pse duhet me qenë ne planin lokal të veprimit për barazinë gjinore fjala përshëndesë e kryeartit te komunës. E dyta, nga 13 drejtori i ka vetëm 3 pozita qe udhëhiqen nga gratë.

Besiana Syla, tha se sa i perkat ketij plani eshet i duhur dhe i mirepritur, une e kam lexuar dhe kam bere krahasime me komunat tjera dhe e kam par qe eshte marr nga komunat tjera fqinje dhe nuk po shihet qe eshte bere ndonje analize. Ne plan jeni thirre ne kornizen afatmesme buxhetore, por une e kam verejt qe shume pak perfillet korniza buxhetore. Une i kam disa propozime sa i perket ketij plani qe kjo strategji te kthehet ne plotesim dhe te kthehet prape ne kuvend dhe te perfshihet dhe disa ceshtje te tjera. Ne grupi i VV-se e abstenojme kete propozim vendim.

Diamant Bytyqi, nenkryetar i komunës tha se ai qe diskutove ti eshte një plan tjetër dhe do te jetë ne seancat e ardhshme ne kuvend. Ky eshte një plan i kompletuar me shumë aktiviteteve, i ndarë ne disa objektiva dhe mbi 6 aktivitete. Fjala e kryetarit duhet te jetë ne çdo plan pasi e lyp korniza ligjore. Ndërsa sa i perket komisionit vetëm 3 jemi kane nga gjinia mashkullore. Ne plan i keni te detajuar çdo gjë.

Egzona Bytyqi, tha se sa i perket planin një plan shumë i mire dhe ne e mbështesim si grup i PDK-së

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit qe te permiresohen dhe korrigjohen gabimet teknike dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 24 vota për,4 abstenime, aprovoi propozimin

IX

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Elmaze Behlulit, drejtoreshë e DA e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se na e perkrahim sikurse edhe vitet e kaluara, mirepo kerkoj qe edhe sindikatës se shendetësisë dhe arsimit të ju bëhet një perkrahje e tillë.

Arsim Jashari, tha se punëtoret e administratës janë ne gjendje shume te keqe me page ,ne mbështesim ketë propozim, por propozoj qe ne fund te vitit me ju dhen enje bonos këtyre zyrtareve.

Gentianë Hoxhaj, tha se ne grupi i LDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi propozimin

X

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer për subvencionimin e qumështit

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepit, DBPZHR i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se ne si grup e përkrahim këtë propozim, por kërkoj nga kryesuesi që qetu fjalimet e përkrahi, e përkrahi me i ndaluar, pasi që e shihet ashiqare po behën vetëm me ra në vlerësimin e një organizate që po e bënë vlerësimin e punës së asamblistëve. Se edhe unë me koleget e mi mujm me dal me thanë e përkrahim e përkrahim.

Daut Azemi, kryesuesi i kuvendit tha se është një rregullore e punës së kuvendit që ja lejon secilin anëtar të kuvendit me përkrah ose jo.

Fadil Spahi, tha se unë shume here epi mendim për mbështetje, por duhet të ipet edhe një sqarim pse po e mbështes dhe çdo here e kam dhënë arsyetimin pse e kam mbështet një propozim. Ndërsa sa i përket propozim vendimit për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer për subvencionimin e qumështit, pasi që qëllimi i këtyre mjeteve është për subvencionimin me nga 4 cent të 50 fermerëve të komune së Lipjanit unë e mbështes këtë propozim.

Arsim Jashari, tha se është e drejtë e secilit me përkrah ose jo, por mundet edhe ne emër të grupit me mbështet. Ndërsa sa i përket këtij propozimi në grupi i PDK-së, e mbështesim.

Besiana Syl, tha se sa i përket propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer për subvencionimin e qumështit unë mëno

qe shuma prej 4 cent është shumë e vogël, unë kisha kërkuar një rritje qe te jete afër 10 centë minimumi. Por nëse nuk ka mjete te mjaftueshme edhe e kështu e përkrahi.

Armend Grajqevci, tha se ne grupi i LDK-së e përkrahim këtë propozim pasi qe deri me tani nuk ka pas subvencione te tilla.

Rexhep Rexhepi, tha se vetëm desha me e sqaruar qe shuma është 37550 mije euro dhe janë gjithsej 50 përfitues.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për, aprovoi propozimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15:15.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi